

RIMËKËMBJE, GJITHPËRFSHIRJE, QËNDRUESHMËRI

Buletini nr. 12 →

KORRIK 2022



RINGJALLJE
INVESTIM
MBËSHTETJE
QËNDRUESHMËRI
KOORDINIM
PUNËSIM
MIRËQENIE
BARAZI
JETËSIM
EKONOMI

Për buletin

INDEP në kuadër të projektit “Rimëkëmbje për Qëndrueshmëri” ka monitoruar implementimin e Pakos së Ringjalljes Ekonomike dhe ka informuar qytetarët e Republikës së Kosovës për masat që kjo pako përmban. Për gjatë 12 muajve të monitorimit, përmes buletineve, infografikave, raporteve monitoruese, analizave dhe materialeve të tjera informuese, INDEP ka tentuar të mbajë të informuar qytetarët rreth përfitimeve të pakos stimuluese, ka rekomanduar Qeverinë e Kosovës për hapat e mëtutjeshëm dhe ka monitoruar zbatimin e kësaj pakoje. Të gjeturat dhe informacionet e tjera të shpalosura nga INDEP kanë pasur për qëllim të përmirësimit

së implementimit dhe krijimit të qëndrueshmërisë afatgjate, krahas rimëkëmbjes së gjelbër që do të duhet të kishim në Republikën e Kosovës. Përmes edicionit të dymbëdhjetë të buletinit, janë paraqitur informata rreth implementimit të masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, karakteristikave që kanë pasur këto masa si dhe ndikimit të tyre. Ndër këto masa, vlenë të theksohet se jo të gjitha kanë gjetur zbatim të duhur dhe se pritet që të vihen në zbatim të tërësishëm gjatë periudhës së mbetur të zbatimit të pakos. Kjo për faktin se zbatimi i këtyre masave do të ndihmonte qytetarët krahas problematikave që pandemia COVID-19 ka shkaktuar.

MASA 1

MBËSHTETJA E PUNËSIMIT

Qëllimi i masës së parë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike ishte ofrimi i ndihmës në sektorin e punësimit, në mënyrë që sado pak të lehtësohet dëmi i shkaktuar nga pandemia COVID-19. Andaj edhe nënmasat e saj dhe implementimi i tyre kanë ofruar ndihma për sektorët dhe personat më të prekur. Rikthimi në punë ka qenë veçanërisht i mundshëm për punëtorët që mbanin një lidhje me punëdhënësin e tyre të mëparshëm. Masat e detyrueshme të distancimit shoqëror si qëndrimi në shtëpi dhe urdhrat e mbylljes kanë pasur një efekt relativisht të vogël në rimëkëmbjen e punësimit, ndërsa shpërndarja e virusit ka pasur një efekt më të madh. Kjo tregon se rikthimi në punë dhe krijimi i vendeve të reja të punës do të jetë më i lehtë dhe më i arritshëm me rastin e përfundimit të pandemisë.

Sa i përket masës së parë të kësaj pako, e cila i përmban shtatë nënmasa, operacionalizimi i saj ka filluar me datë 29 korrik, kur edhe filloi zbatimi i nënmasës 1.2 Mbështetja për të punësuarit e formalizuar. Masa e parë në tërësi ka synuar të krijojë stabilizim dhe lehtësime për personat të cilat kanë humbur vendin e tyre të punës dhe formalizim për personat që kanë qenë të inkuadruar në ekonominë joformale. Kjo masë ka gjetur zbatim të kufizuar, duke e ditur se jo të gjitha masat e saj janë përbushur tërësisht, mirëpo pako nuk ka datë të caktuar të përfundimit të implementimit të saj, andaj vazhdimi i implementimit të masave do të vazhdojë edhe për muajt në vazhdim.




MASA 2

RINGJALLJA E EKONOMISË DHE PRODHIMIT

Ekonomia ishte ndër sektorët më të prekur nga kriza globale e shkaktuar nga pandemia për gjatë muajve të fundit. Kjo pasi që u kufizua lëvizja e lirë, pati mbyllje të kufijve dhe u vështirësua mbarëvajtja e jetesës. Ekonomia e cila mbledh afër vetës të gjithë sektorët e tjerë, duhet të mbështetet në mënyrë që të tejkalohet dëmi i shkaktuar. Andaj në Pakon e Ringjalljes Ekonomike, masa e dytë e integruar ishte hartuar për mbështetje të ekonomisë dhe prodhimit, e kjo masë ka pasur gjithsej të ndara 108 milionë euro. Kjo është paraparë të shpërndahet në gjashtë nënmasa, të cilat janë:

1. Subvencionimi i kredive investive
2. Mbështetje bizneseve për qasje në financa
3. Investime në TI dhe Inovacion
4. Mbështetja e Eksportit
5. Ringjallja e fshatit përmes bujqësisë dhe agro-turizmit
6. Rikuperimi i hotelerisë dhe bizneseve të mbyllura

Masa e dytë e Pakos së Ringjalljes Ekonomike konsiston në veprime me qëllim përmirësimin e strukturës së përbërjes së PBB-së përmes favorizimit të sektorëve të caktuar ekonomikë, sidomos prodhimin dhe përmirësimin e bilancit tregtar të vendit. Por zbatimi i masës së dytë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike ka gjetur zbatim mjaft të pjesshëm për gjatë 12 muajve të fundit. Zbatimi i pjesshëm ka bërë që edhe efektet e kësaj mase të mos jenë shumë të dukshme dhe të mos ofrojnë rimëkëmbje të qëndrueshme për kategoritë përfituese të kësaj mase. Mirëpo, efektet ekonomike të karakterit që këto masa mbajnë në vete, japin efekte pas një periudhe më afatgjate, andaj me vazhdimin e implementimit të mëtutjeshëm të pakos, efektet që këto masa kanë synuar të prodhojnë mund të bëhen edhe të më të dukshme dhe mund të ofrojnë stabilitet ekonomik dhe sigurim të zhvillimit ekonomik.




MASA 3

MBËSHTETJA PËR FAMILJEN

Pandemia COVID-19 ka dëmtuar rëndë ekonominë e secilit shtet, e gjithashtu ka shkaktuar dëme dhe vështirësi për secilën familje. Vdekjet e shkaktuara si rrjedhojë e pandemisë dhe pasojat tjera shëndetësore dëmtuan familjet dhe shoqërinë në aspektin emocional, ekonomik dhe social. Pako e Ringjalljes Ekonomike, si masë të tretë të saj ka Mbështetjen për familjen, masë së cilës ia ka dedikuar gjithsej 50 milionë euro. Përmes këtyre mjeteve, Qeveria e Kosovës ka synuar të lehtësojë situatën e vështirë që pandemia kishte sjellur në derën e secilës familje në Republikën e Kosovës.

Masa e tretë e Pakos së Ringjalljes Ekonomike është një nga masat që ka gjetur më së shumti zbatim dhe implementim. Kjo për faktin që secila nënmasë e kësaj mase ka filluar zbatimin dhe disa prej tyre tashmë edhe kanë përfunduar, ndërsa mbështetja për lehonat, shtesat për fëmijë dhe reforma e asistencës sociale janë masa të cilat ende po zbatohen. Masa e tretë në esencë ka pasur karakter social, me synim kryesor mbështetjen e familjeve pjesë e shtresave më të cënueshme të shoqërisë siç janë familjet në asistencë sociale, të pensionuarit, familjet që kishin humbur kryefamiljarin nga COVID-19, gratë lehona të papuna dhe familjet me vështirësi kreditore. Nga aspekti social, kjo masë ka pasur efekt duke ditur që janë shpërndarë të holla për kategoritë të cilat kanë qenë të kualifikuara në kushtet që ishin të vendosura për përfitime nga nënmasat e masës së tretë.



MASA 4

MBËSHTETJA PËR PUBLIKEN

Për nga karakteri i ndihmave, masa e katërt ka tentuar që përmes pandemisë, të përmirësohen kushtet e shërbimeve dhe të kontribuohet në qëndrueshmëri afatgjate tek sektorët publik si shëndetësia, arsimi, kultura dhe sporti, siguria dhe ndërmarrjet publike. Gjithashtu, lehtësim përmes kësaj mase është ofruar edhe për mërgatën, duke mbuluar shpenzimet e policave kufitare gjatë qëndrimit të tyre në Republikën e Kosovës. Në tërësi, kjo masë ka pasur të alokuara 112 milionë euro, shumë kjo e cila deri më tani ka gjetur zbatim të pjesshëm në vendin tonë.

Mbështetja për publiken është masë e cila në aspektin e gjelbër nuk ka kontribuar, ndërsa në aspektin social ka pasur ndikim të kufizuar. Në tërësi karakteri i pakos, duke përfshirë edhe këtë masë, nuk kanë pasur për synim një rimëkëmbje afatgjate dhe rimëkëmbje që do të shërbente për zhvillim të qëndrueshëm, por ka synuar të përmirësojë vështirësitë aktuale, duke bërë të mundur vetëm lehtësime mujore. Një karakteristikë e tillë ka bërë që pako deri më tani të mos ofrojë efekte shumë të dukshme, e një gjë e tillë është kundërshtuar edhe nga ana e INDEP, për faktin që qëndrueshmëria afatgjate dhe zhvillimi ekonomik janë më të rëndësishme se sa tejkalimi i vështirësive dhe arritja e paqes sociale për vetëm disa muaj.



MASA 5

INVESTIMI NË INFRASTRUKTURË DHE AMBIENT

Investimi në infrastrukturën dhe ambient, duke pasur fokus kryesor sektorin e energjisë mund të përmirësojë cilësinë e jetës së një shteti, mjedisin dhe mundësitë. Kjo pasi që përmes përmirësimit të infrastrukturës dhe tranzicionit energjetik, krijohen kushte për investime të reja nga investorët e jashtëm, por edhe ata të brendshëm. Gjithashtu me krijimin e një infrastrukture të qëndrueshme dhe orientimit të sektorit energjetik nga burimet e gjelbërta, kontribuojmë në ambient dhe në mbrojtjen e mjedisit.

Masa e pestë e Pakos së Ringjalljes Ekonomike, ishte cilësuar dhe vazhdon të cilësohet si një nga masat kryesore të kësaj pakoje. Kjo për faktin që orientimi i kësaj mase, do të mund të kishte karakter të rimëkëmbjes së gjelbër, duke kontribuar kështu në rimëkëmbje nga pandemia, e në të njëjtën kohë duke krijuar vende të reja të punës, infrastrukturë më të mirë, kapacitete të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe stabilitet energjetik. Mirëpo kjo masë deri më tani ka gjetur zbatim shumë të vogël për mos të thënë fare, andaj efektet e saj nuk janë të dukshme dhe nuk kanë ofruar përmirësim të situatës. Duke parë edhe shembujt nga vendet e tjera të cilat shfrytëzuan pandeminë për të pasur një gjelbërim të sektorëve të shtetit të tyre, edhe INDEP që nga fillimi kishte propozuar që Republika e Kosovës të ndjek udhën e njëjtë dhe masa e pestë kishte karakter adekuat për të bërë një tranzicion të tillë.



PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME →

- Pako e Ringjalljes Ekonomike dhe masat e integruara në të, kanë gjetur zbatim të kufizuar që nga fillimi i implementimit të tyre. Ndikimi i kësaj pakoje ka pasur efekte në aspektin social dhe atë ekonomik, mirëpo ky ndikim nuk ka qenë me karakter afatgjatë dhe nuk ka siguruar rimëkëmbje të qëndrueshme dhe të gjelbër. Një gjë e tillë e bënë këtë pako të ngjashme me pakot e kaluara stimuluese në Republikën e Kosovës, duke vazhduar kështu distancimin nga zgjidhja e vërtetë e problemeve që pandemia COVID-19 ka shkaktuar në vendin tonë.
- Ekzekutimi i masave që nga fillimi i implementimit të pakos e deri më sot nuk ka ecur në mënyrë paralele, dhe derisa një masë është ekzekutuar më intenzivisht, një masë tjetër ka mbetur prapa. Do të ishte shumë efektive sikur të gjitha masat të ecin paralelisht dhe bashkë për të siguruar kohezionin dhe sinergjitë e mundshme. Kjo pasi që në këtë mënyrë do të arrihej një gjithpërfshirje e qytetarëve që do të jenë përfitues nga masat e pakos.
- Qeveria e Kosovës duhet të vazhdojë implementimin e pakos duke bërë të mundur zbatimin e plotë të të gjitha masave. Kjo për faktin që edhe hartimi i pakos fillimisht, ka paraparë që efektet do të arriheshin me rastin e implementimit të plotë të të gjitha masave, e jo në zbatim të kufizuar të tyre. Andaj, zbatimi i plotë i pakos duhet të jetë një nga prioritetet kryesore të Qeverisë së Kosovës për muajt në vazhdim.

- Hartimi i një pakoje të re stimuluese, ku në qendër të saj është rimëkëmbja e gjelbër, duhet të ndodhë sa më parë. Kriza e shkaktuar nga pandemia COVID-19, e përkrahur më pastaj nga ngritja e çmimeve dhe inflacioni, duhet të ndiqen me një pako e cila lehtëson vështirësitë e qytetarëve, krijon vende të reja të punës dhe ofron qëndrueshmëri afatgjate për të gjithë. Shfrytëzimi i pandemisë për avancim të proceseve të tjera, siç janë tranzicioni i energjisë, shtimi i vendeve të punës dhe zhvillimi ekonomik duhet të përkthehen në pako stimuluese në të mirë të qytetarëve në rradhë të parë, e pastaj edhe në kuadër të arritjes së objektivave që Republika e Kosovës i ka.



“Ky projekt mbështetet nga Balkan Trust for Democracy (BTD) një projekt i Fondit Gjerman Marshall të SHBA-ve dhe popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe zbatohet nga Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet apo opinionet e BTD, GMF, USAID ose Qeverisë së SHBA-së.”